

# VAJZA ME ÇANTE SPORTIVE

TREGIME

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

854-32

K-15



891.783-52

V 13

S

VAJZA  
ME ÇANTE  
SPORTIVE

TREGIME

~~56918~~ 3296



SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

## GRATË E FSHATIT TONË

Në fshatin tonë kishin pllakosur gjermanët dhe mercenarët e Xhafer Devës. Ishte mesi i janarit të vitit 1944 dhe dimër si atë vit nuk mbahej mend.

Në këtë dimër të paparë, kur fillon tregimi ynë, operacioni i egër i gjermanëve, i mbërtheu fshatarët brenda katër mureve të shtëpisë dhe ullinjtë (ashtu si fiqëtë në verë), piqeshin e breshëronin për tokë e kalbeshin shpejt pa arritur t'i mblidhним, kurse për portokallet, nerënxit e mandarinat, as që bëhej fjalë. Me to ëmbëlsoheshin gjermanët dhe mercenarët e Xhafer Devës.

Unë isha i vogël, s'kisha mbushur dhjetë vjeç dësh as fjalën operacion nuk e kuptoja dhe as mercenarët e Xhafer Devës nuk i merrja vesh, tek kërkonin petulla me gjalpë. Dhe kur them që kërkonin petulla me gjalpë nuk tallem hiç. Ata domin petulla me gjalpë, kurse ne as miell të grunjëtë nuk kishim dhe as gjalpit nuk ja mbanim mend se si e kishte erën atë dimër. Bagëtia na kishte ngordhur me kohë. Ishte luftë. Ky Xhaferi që atëhere më dukej se ishte kushiëri i Hitlerit, mbase edhe vëllai i tij i vogël, pasi edhe emrat u mbaronin njësoj dhe të bëmet i kishin njësoj. Në edhe atë pikë vaj që kishim e ruanim si ujët e bekuar

të gjyshes, pasi me të mund t'i shtyje lakrat e egra e përkalidhet. Kurse mercenarët donin petulla dhe gjermanët proshuto me mish derri. Por ne fjalën proshutë e dëgjonim për herë të parë. Gjyshja u thosh që «ju jeni vetë derra», por gjermanët nuk dinin shqip që t'i merrnin vesh fjalët e saj.

Dimri ishte i egër shumë. Të shumtën e kohës unë rrija shtrirë në dërrasa, tok me mëmën time. Mëma ishte e re, por e sëmurë.

Unë kam dashur të mësoja gjithmonë se ku ishte babai atë dimër. Po babai nuk u kthyte më në fshat. Ai mbeti maleve, vrarë nga gjermanët, jo atë dimrin që s'do ta harrojmë kurrë, por në verë, kur kishte dalë bari i ri dhe kur kopetë kishin filluar të ngjiteshin përpjetë maleve, që kundërmomin erë trëndeline dhe çaji. Mbase ndaj dhe u vra babai në verë që të rrinte gjithmonë me bagëtinë dhe me trëndelinë si çoban që kishte qënë...

Babait i thrissin Nase, si atij trimit që i këndohet kënga. Për Nase Labin e kam fjalën. Ndosta nuk ju kujtohet: është ai që i tha marshallit të Italisë:

Mua s'më lidhi Turqia  
Jo do më lidhë Italia!



Dhe gjithmonë si atëhere, kur akoma s'kisha mbushur dhjetë vjeç, edhe sot që jam burrë, emri Nase më duket se është emër për trima, për kapelanë e partizanë. Dhe atë dimër, tek rrija e ngrohesha në shtrojet e mëmës së sëmurë, mendoja që babit tim duhet t'i këndohej kështu:

Mua s'më lidhi Italia,  
Jo do më lidhë Gjermania!

Se italianin e kishin mundur partizanët dhe tani ishte radha e gjermanit. Kurse, ngadonjëherë,

kur vinin mercenarët e Xhafer Devës në shtëpinë  
tonë, më shkonte mendja edhe kështu:

Mua s'më lidh dot Hitleri,  
Jo do më lidhë Xhaferi!

Dhe kështu ishte vërtet. Babanë me shokët e  
tij atje në male, nuk i lidhte dot as Hitleri dhe as  
Xhafer Deva, që na kishin zënë shtëpitë.

Gjermanët erdhën e na i morën edhe ato pak  
velenxa të leshta që i kishte punuar mëma, kur  
kishte qënë mirë me shëndet. Tani as ergalin nuk  
e kishim më. Mercenarët e Xhafer Devës na e do-  
gjën për dru, që të ngroheshin. Atyre nuk u mjaf-  
tonin as batanijet e Italisë, as çarçafët e gjyshes  
dhe as velenxat e mëmës sime të sëmurë. Uh, sa  
të babëzitur që ishin.

Fshati po hiqte të zitë e ullirit atë dimër. As  
gjyshja ime, që qe grua e vuajtur dhe e munduar  
shumë, nuk dinte si ta quante atë dimër. Herë-herë  
ajo thoshte se i kishte ardhur fundi botës, «kata-  
lizmoi».

Por kur ne hiqnim të zitë e ullirit, që në fund  
të fundit ishim brenda në shtëpi e më të rrallë  
edhe e ngjenim kërkën e misrit me lakrat e  
ëgra, po partizanët atje, në malet e Gurrës, ç'bë-  
nin? Si i bënin ballë këtij dimri? Bora atje në  
Gurrë ishte dy bojë njeriu dhe kishte ngrirë e ishte  
bërë akull, aqë sa edhe me kazmë nuk çuhej. Për  
të ngrënë partizanët nuk kishin, pasi as lakra e  
as bari nuk gjendeshin dot nën atë shtresë të tra-  
shë bore, as derr i egër e as dru që të ngroheshin  
nuk gjendeshin. Majat e maleve tona në këtë anë  
të bregut janë të zhveshura fare. Thonë që dikur  
ka pasur pyje me pisha, si në Llogora, por njerëzit  
i kanë djegur për të fituar kullota dhe tani ato  
ishin si male të nëmura, pa asnje dru.

... Ato ditë kur gjermanët dhe mercenarët kishin pllakosur fshatin tonë dhe kishin rrrethuar gjithë fshatrat e tjerë të Bregut, që të mos u shkonte dot asnjë ndihmë partizanëve në mal, ato ditë kur ata e kishin vënë ndërmend t'i shuanin partizanët në malet e Gurrës me uri e me të ftohët, jo vetëm gjyshja, mëma ime dhe unë mendonim për partizanët, po për ta mendonin të gjithë fshatarët.

Në ato ditë të gjata dimri e shumë të hidhura, qoftë nga të ftohtit e ca më tepër nga armiqjtë, gratë e fshatit, vajzat, motrat, nënët dhe gjyshet, bënin çorape e fanella të leshta për djemtë e malit. Gjyshja tirte leshin me furkën e gjatë sa unë, kurse mëma bënte, ashtu rënë, çorape prej leshi të butë, që partizanëve të mos u mbërthenin këmbët e të mos i vrисnin opingat.

Gratë e fshatit tonë bënë atë, që ai dimër të mos harrohet kurrë në anët tona.

Ato ditë janari çdo grua kishte gatuar bukën e misërt në magje, kishte nxjerrë ullinjtë e fundit nga talëret e qilarit dhe kishte mbaruar çorapet e fanellat e leshta. Partizanët e kompanisë së dytë të batalionit të parë atje në Gurrë, për t'u bërë ballë këtij dimri dhe këtij operacioni armik, kishin shumë nevojë për atë bukë, për ata ullinj dhe për ato çorape e fanella të leshta.

Dhe gratë i kishin bërë gati të gjitha.

Në shtëpinë e Zahet, që ishte bërë me kohë si depo e partizanëve, qenë grumbulluar njëqind e tridhjetëkatër palë çorape dhe tetëdhjetë e një fanella të leshta, hem të buta hem të sarta. Këto ishin siguruar, por si t'u dërgoheshin partizanëve, asnjë nuk e dinte.

... Një pasdite tek ne, si për të takuar nënën time të sëmurë, erdhën Takja e Mitrushit, mëmë

e dy djemve partizanë, Lilua e Zahet, që kishte tre vëllezër partizanë, Dhoksia e Thanet, që kishte dy motra dhe vëllanë partizan, dhe një vajzë e re, që mbasë donte të delte vetë partizane.

Në shtëpinë tonë drutë ishin mbaruar dhe vaj nuk gjetën më as gjermanët as mercenarët, andaj tek ne atë pasdite nuk kishte më nga ata. Ishin larguar nga ne e qenë ngulur në shtëpi të tjera. Nëna kujtonte se ata ishin trembur se mos u ngjitej veremi i saj, ndaj qenë larguar. Kurse gjyshja thoshte që as kolera nuk i zë ata, jo veremi, vetëm plumbi i partizanëve bën punë në ta.

Gratë erdhën tek ne, e si pyetën për shëndetin e mëmës, filluan pastaj të flisnin për punën e çorapeve dhe të fanellave.

— Janë shumë, një barrë e mirë mushke, — tha e para Takja e Mitrushit.

— Sikur të nisnim ndonjë nga pleqtë e fortë të fshatit, si për në Kallarat. Ta ngarkojmë kafshën me plaçkat e djemve, t'ja kuçundrisnim me ullinj, që të mos dukeshin çorapet e fanellat e, po ta takojnë të paudhët në të dalë të fshatit, t'u thotë që vete të këmbej ullinjtë me miell të grunjtë në Kallarat. Mbështetur gënjen e Xhafer Devës, se për petulla këta shesin edhe nënën; — dha mendimin e saj Lilua e Zahet.

— Punë që s'bëhet ajo. o bijë! — tha gjyshja ime menjëherë — Gjermanët, sa të marrin vesh që kafsha e ngarkuar me ullinj po ngjitet malit do ta kuptojnë që shkon tek partizanët, kështu që do ta vrasin në vend dhe plaçkat nuk do t'u venë djemve në mal. «Pse, me ullinj do t'i ushqejmë partizanët»? — do të thonë gjermanët. — Duhet menduar nonjë gjë tjetër, kjo nuk vete fare, — shtoi ajo.

— O hallë Mara, po sikur të nisej ndonjë nga burrat që ka mbetur në fshat, ndonjë nga ata të teritorialit, natën, pa e diktuar njeri? — pyeti gjyshen Dhoksia e Thanet.

— Mirë do të ishte. Po të mos e diktonin ama, — ndërhyri në vend të gjyshes Takja e Mitrushit. — Po kush na siguron që do të mundë të ikë ai pa u rënë në sy e në vesh koshallëve të gjermanit? Mirë po iku, po në mos iktë dot? Edhe njeriu vete dëm, edhe mallin e merr dreqi e djemtë do të na mbeten brinjëve të malit...

— Jo, nuk e kam menduar kaq thellë, — u shfajësua Dhoksia.

Ato po e pleksnin dhe shpleksnin historinë për t'u shpënë gjënë partizanëve në mal, gjithfarë mënyrash, edhe kështu edhe ashtu, e nuk po ja delnin dot mbanë. Më dukej se këtë punë më mirë se kushdo mund ta zgjidhnin burrat, por ato nuk kishin thirrur asnjë burrë. Nuk e dija unë që burrat, ata pak burra që kishin mbetur në fshat, ua kishin besuar këtë shërbësë grave dhe vajzave, se për të çarë rrëthimin e gjermanëve e të mercenarëve të Xhafer Devës më lehtë do ta kishin gratë.

Dhe gratë në shtëpinë tonë vazhdonin të shkëmbin mendime për çorapet dhe fanellat e partizanëve.

Deri tani ajo vajza e re, që mbasë donte të delte partizane, nuk kishte folur fare. Por tani i erdhi radha edhe asaj të thoshte fjalën.

— O mëmanı, o motrani, po sikur të na i linit ne vajzërisë së fshatit t'ua shpinim mallin partizanëve?

— Folë më shkoqur, — tha Takja e Mitrushit.

— Ja, ne vajzave na ka vajtur mendja kështu:

T'u themi mercenarëve dhe gjermanit se do të ngjitemi deri në Mblerëz për dru. Se drutë na duhen dhe neve edhe atyre të liqve, që na kanë zënë shtëpinë. Zjarri në vatër është i mirë për të gjithë. Dimri do të vijë edhe më i egër, kurse dru s'kemi fare. Kështu nisemi për në Mblerëz, pa po vrapin do ta mbajmë më tej, në majë të malit të Çikës, në Gurrë. U shpiem partizanëve fanellat, çorapet, bukën e ullinjtë, që do të kemi me vete. Pastaj, më t'u kthyer, fët e fët një vrap në Mblerëz, bëjmë ca marishte dhe mbrëmanet në darkë kthehemë në fshat me barrën e druve ngarkuar. Veç për këtë duhen gra të forta, ndaj them të na e lini ne, vajzërisë, të çajmë malin, — tha vajza e re.

Gjyshja ime me shoqet e saj nuk po e kuptonin se si do t'i çonin këto vajza çorapet e fanellat në majë të Çikës. Ndaj Lilua e Zahet e pyeti vajzën:

— Mirë, o zemër. Ta zëmë se ua hodhëm këtyre të paudhëve që nisemi në mal për shqopa e mare, se mirë e the, zjarri është i mirë për të gjithë. Por si kujton ti, se nuk do të na kontrollojnë trastat apo futat?

Problemi u shtrua tani thjesht, pa asnje më-dyshje. Dhe mua m'u duk se ajo vajza mbeti ligsht. Vallë si do të përgjigjej? Por u habita kur dëgjova:

— Jo. Ne nuk kujtojmë se nuk do të na kontrollojnë trastat e futat. Por ne mendojmë të bëhem i nja njëzet-tridhjetë vajza, nga më të fortat e fshatit, që ta ngjisim majën e Çikës jo për shtatë-tetë orë, po e shumta për pesë orë dhe, më të zbritur, do të arrijmë të bëjmë edhe shqopë e kucure për zjarr.

Ajo ndjeu që përsëriti atë që kishte thënë pak

më parë dhe që kështu akoma nuk i kishte dhënë përgjigje pyetjes së Lilos së Zahet dhe shtoi:

— Kurse çorapet dhe fanellat ne themi t'i veshim vetë. Të mbathim nga tre-katër çorape dhe të veshim nga dy apo tri fanella në mish. Sado të djallëzuar të jenë mercenarët dhe gjermanët, nuk besoj se do t'iu vejë mendja të na numërojnë sa çorape kemi mbathur.

Pashë që edhe gratë e tjera e miratuan këtë mendim të vajzave. Megjithatë Dhoksia tha:

— Por për bukën e partizanëve si do t'ja bëjmë? Atë nuk e vesh e as e mbath dot si fanellat e çorapet.

— Ne kemi menduar edhe për këtë, — tha vajza. — Themi të marrim për udhë nga një gjysmë karvele buke a gjysmë kulaçi dhe një çanak ullinj, sa për vete. Të gjithë bukën dhe ullinjtë t'ua japid partizanëve, kurse për vete atë ditë të rrimë pa ngrënë.

— Ne mund të dëndemi me përvlak mirë atë mëngjez që do të nisemi, — tha Dhoksia.

— Po, — tha vajza dhe vazhdoi, — Do ta kemi vështirë shumë. Ndaj themi që duhen vajza e gratë reja e të forta, pasi do të duhet të bëjmë mbi dhjetë orë rrugë, të ngjitemi e të zgresim malet në mes të borës e të suferinës, të bëjmë drutë e të kthehemë në fshat me to ngarkuar.

— Dhe të gjitha me bark thatë, — tha Dhoksia si për të plotësuar mendimin e vajzës.

Unë, që e kisha ngjitur një herë malin për të gjetur babanë në malet e Bufit, e dija sa e vështirë ishte ajo rrugë, prandaj prisja ç'do të thoshin gjyshja me shoqet e saj.

— Mirë e keni menduar, bija, — tha gjyshja